



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj.16923/ 2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, përmes Gjyqtarës **Salihe Berisha – Ahmetaj** me sekretarin juridik Naim Thaqi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Adnan Musli Dragaj nga Qagllavica – Dardana e Re për shkak të kundërvajtjes nga neni 16.1.1, e në lidhje me nenin 6.2. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publike, në bazë të nenit 37, 195, të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën **05.07.2010**, harton këtë

**A K T V E N D I M**

I pandehuri **Adnan Musli Dragaj** i lindur më 28.09.1968 në Prishtinë, me vendbanim në Qagllavicë – Dardania e Re p.n., Kordinator i prog. Në Universitetin e Prizrenit, i martuar, të kryer fakultetin e dizajnit, i gjendjes së mirë ekonomike i pa denuar më parë për kundërvajtje, nuk është nën hetime,

**Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E**

Sepse nuk ka deklaruar pasurinë për vitin 2009 në Agjensionin kundër Korrupsionit në Prishtinë deri me datën 31.03.2010.  
- me çka i pandehuri ka kryer kundërvajtjen nga neni 16.1.1, e në lidhje me nenin 6.2. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publike, andaj në bazë të dispozitave të të njëjtit Ligj

**D Ë N O H E T**

**ME DËNIM NË TË HOLLA** në shumen prej **900 €**, të cilin denim e pandehura është e obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e nëse pagesen nuk e bën në afatin e cekur, dënimi me të holla ka për t'iu zëvendësuar me denim burgu në kohëzgjatje prej **30** ditësh, duke llogaritur një ditë burgu me **15 €**.

Obligohet e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **5 €**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

Dënimin dhe paushallin gjyqësor e pandehura e paguan në këtë gjykatë.

Me nga një kopje të Aktvendimit të njoftohen i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës.

**A r s y e t i m**

**Agjencia kundër Korrupsionit**, me kërkesën nr.01/2300/10, të datës 15.06.2010 ka propozuar që kundër të pandehurit, të zhvillohet procedura kundërvajtëse, të shpallët përgjegjës dhe të ndëshkohet në bazë të Ligjit, për shkak të kundërvajtjes të përshkruar në dispozitiv.

Sipas kërkesës së parashtruar është zhvilluar procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Adnan Musli Dragaj, i cili mbrojtjen e paraqitur pranë kësaj gjykate pranon të dhënat nga kërkesa se ka kryer kundërvajtjen që i vihet në barrë sipas kërkesës së para datës 31.03.2010. nga Agjencia kundër Korrupsionit e ka pranuar formularin për ta deklaruar pasurinë por kete veprim nuk e ka bere, gjegjesisht nuk e ka deklaruar pasurine per shkak te obligimeve te medha ne pune por edhe nga neglizhenca.

Pas shtjellimit të provave gjatë procedurës, shiqimit të të dhënave në kërkesë dhe deklarates së të pandehurit gjykatësja ka fituar bindjen e lirë se i pandehuri është përgjegjës për kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit 16.1.1, e në lidhje me nenin 6.2. të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publike, Sepse nuk ka deklaruar pasurinë për vitin 2009 në Agjensionin kundër Korrupsionit në Prishtinë deri me datën 31.03.2010. prandaj duke marr parasysh tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në shqiptimin e drejtë të dënimit Ligjor, duke pasur parasysh se dënimi i shqiptuar do të ndikoi pozitivisht që në të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme, i shqiptoi dënimin me të holla, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 109 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

**Nr. 16923/ 2010 të datës 05.07.2010**

**GJYKATËSJA**  
**Salihe Berisha – Ahmetaj**

**UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK** Kundër këtij aktvendimi të drejtë ankese kanë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës, Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi përmes kësaj gjykate, pa pulla.

|                                                          |               |
|----------------------------------------------------------|---------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO |               |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT                             |               |
| AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE                                |               |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY                                   |               |
| Dep. _____                                               | Nr. _____     |
| Dep. _____                                               | Pril NO _____ |
| Dep. _____                                               | DRIP _____    |
| Nr. i faj _____                                          | Urdim _____   |
| Broj stranica _____                                      | Date _____    |
| Nr. pages _____                                          | PRISHTINE     |